



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

**Zyra e Kryetarit**

Bazuar ne Ligjin per Veteqeverisje Lokale, Nr: 03/L-040, neni 68, Statutit te Komunes Junik te dates 29.9.2010, neni 60. Komuna Junik organizon:

**TAKIM PUBLIK ME QYTETARE**

**Të nderuar bashkëqytetarë,**

Ju njoftojmë se të Marten, më datë: 31.12.2024 në orën 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Junikut, do të mbahet takim i hapur me qytetarë, ku të gjithë të interesuarit mund t'i drejtohen kryetarit të komunës për:

- Të arriturat e komunës së Junikut për vitin 2024,
- Infrastruktura komunale (rrugore, ndriçimi, kanalizimi, uji i pijes),
- Shërbimet administrative komunale,
- Planifikimin Urban të Qytetit,
- Buxhetin Komunal,
- Aktivitetet kulturore dhe sportive,
- Prioritetet e komunës për vitin 2024.

Rëndësi të posaçme në këto takime ka pjesëmarrja aktive e qytetarëve me ide dhe sugjerime për avancimin e punëve të institucioneve komunale. Të gjitha shqetësimet, preokupimet dhe sugjerimet tuaja do të jenë të mirëseardhura në këtë takim.

**Të nderuar bashkëqytetarë, pjesëmarrja juaj në këtë takim dëshmon përcaktimin tuaj për demokraci, ku si parakusht kryesor nënkupton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.**

Kryetari i Komunës

z. Ruzhdi Shehu

